

**UDHËZIM**

**Nr. 16, datë 5.7.2017**

**PËR NJË SHITESË DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 6, DATË 30.1.2015, “PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 159, paragrafi 2 të ligjit nr. 92/2014, datë 24.7.2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, ministri i Financave

**UDHËZON:**

Në udhëzimin nr. 6, datë 30.1.2015, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhet shtesa dhe ndryshimet e mëposhtme:

**1. Në nenin 36, “Zbatimi i shkallës së TVSH-së”, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje: “Shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar, për furnizimin e shërbimit të akomodimit në strukturat akomoduese, sipas kategorive të përcaktuara në legjislacionin e fushës së turizmit, është 6 për qind”.**

2. Modeli i deklaratës së tatimit mbi vlerën e shtuar, i përcaktuar në nenin 67 të udhëzimit, zëvendësohet me modelin e deklaratës së tatimit mbi vlerën e shtuar sipas këtij udhëzimi.

3. Modeli i librit të shitjeve, i përcaktuar në nenin 68 të udhëzimit, zëvendësohet me modelin e librit të shitjeve sipas këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE  
**Helga Vukaj**